



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 132 Akti

Nr. 143 Vendimi
Tiranë, më 26.04.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Firdes Shuli	Relatore
Brunilda Bekteshi	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Mia Roessingh, në datat 19.04.2019 dhe 26.04.2019, pranë Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Rexhep Bekteshi**, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Nenet 179/b, A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, të ndryshuar, me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatimin dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli, mori në shqyrtim shpjegimet e provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Rexhep Bekteshi, proces i cili ka përfshirë kontrollin e të tria kriterëve: atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016 dhe, në përfundim, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Rexhep Bekteshi është subjekti i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, dhe në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim, ligji nr. 84/2016), të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Rexhep Bekteshi, ushtron funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, që prej vitit 1993 dhe aktualisht. Ky subjekt është shortuar nga Komisioni me shortin e datës 15.05.2018.

3. Me shkresën nr. *** prot., datë 08.01.2018, protokolluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit me nr. *** prot., datë 11.03.2018, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka vënë në dispozicion aktin përfundimtar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Rexhep Bekteshi (16 fletë).

4. Me shkresën nr. *** prot., të datës 2.11.2017, protokolluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, me nr. *** prot., datë 4.1.2019, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka vënë në dispozicion raportin mbi kontrollin e figurës të deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. ***, datë 26.12.2018, për subjektin e rivlerësimit, z. Rexhep Bekteshi (2 fletë).

5. Me shkresën nr. *** prot., datë 14.02.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vënë në dispozicion raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Rexhep Bekteshi (36 fletë).

6. Bazuar pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim, “Komisioni”), në datën 15.05.2018 ka zhvilluar shortin, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Rexhep Bekteshi, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjyqësor i përbërë nga komisionerët Roland Ilija, Brunilda Bekteshi dhe Alma Faskaj, relatores së çështjes.

7. Me fillimin e procesit të rivlerësimit, trupi gjykues administroi:

(i) aktin për vlerësimin e pasurisë, sipas neneve 31 - 33, të ligjit nr. 84/2016, të hartuar nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (në vijim, “ILDKPKI”);

(ii) raportin e vlerësimit të figurës, sipas neneve 34 - 39, të ligjit nr. 84/2016, nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim, “DSIK”);

(iii) raportin e vlerësimit profesional, sipas neneve 40 - 44, të ligjit nr. 84/2016, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGJ”).

8. Me vendimin nr. 1, datë 22.05.2018, trupi gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe të rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit, z. Rexhep Bekteshi, duke përfshirë të tria kriteret, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisionerin z. Roland Ilia. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

9. Me vendimin nr. 40, datë 16.07.2018, është bërë rishpërndarja me short e çështjeve të komisioneres Alma Faskaj, nga ku ka rezultuar që me cilësinë e relatorit të çështjes, për subjektin Rexhep Bekteshi të caktohet komisionere Firdes Shuli, e cila ka deklaruar mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

10. Në datë 09.11.2018 subjektin iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues dhe e drejta e deklarimit të konfliktit të interesit me anëtarët e trupit. Subjekti nuk shprehu situatë të konfliktit të interesit me ndonjërin prej anëtarëve të trupit gjykues.

11. Me vendimin nr. 2, datë 05.04.2019, trupi gjykues vendosi:

(i) të përfundojë hetimin paraprak administrativ për të tria kriteret e parashikuara në pikën 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, kriterin e pasurisë, të figurës dhe aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Rexhep Bekteshi;

(ii) të miratojë rezultatet paraprake të hetimit;

(iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se provat e grumbulluara lidhur me vlerësimin e pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale, kanë nivelin e provueshmërisë sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, duke i kaluar atij barrën e provës mbi rezultatet paraprake të hetimit kryesisht, për të paraqitur prova e shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, sipas parashikimeve të nenit 52, të ligjit nr. 84/2016;

(iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për të drejtat e tij në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative;

(v) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi deklarimin e konfliktit të interesit, të drejtën për t’u njohur me dosjen, të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarëve, si dhe afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar konflikt interesi.

12. Në datë 10.04.2019 subjekti vuri në dispozicion në rrugë elektronike parashitjet me sqarimet e tij dhe dokumente shkresore bashkëngjitur.

13. Me vendimin nr. 3, datë 16.04.2019, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Rexhep Bekteshi, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016, datë 19.04.2019, ora 12:15, pranë Pallatit të Koncerteve, ish-Pallati i Kongreseve.

14. Më datë 19.04.2019 u zhvillua seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, z. Rexhep Bekteshi, sipas nenit 55, të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit, dhe vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kritereve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave”, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Rexhep Bekteshi, bazuar në të tre komponentët: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

II. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI

II.1. VLERËSIMI I PASURISË

II.1.a. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Nga aktet e ILDKPKI-së rezulton se subjekti ka dorëzuar rregullisht deklaratat e interesave private për vitet 2003–2016 në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”. Më datë 23.01.2017, subjekti ka dorëzuar “Deklaratën e Pasurisë së Rivlerësimit Kalimtar”, pranë ILDKPKI-së, në përputhje me nenin 32/1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ky institucion ka kryer kontroll të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur, sipas neneve 30-33, të ligjit nr. 84/2016, dhe me aktin nr. *** prot., datë 08.01.2018, ka konkluduar se:

- deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

II.1.b. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Sipas kreut IV, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në përfundim të të cilit paraqet raport me konstatimet përkatëse, në lidhje me vlerësimin pasuror. Referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese, nr. 2/2017^[1] dhe kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen

^[1] “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u

e funksionit të tij kushtetues, ka kryer një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është kushtëzuar nga përfundimet e paraqitura nga ILDKPKI.

Lidhur me pasuritë e subjektit të rivlerësimit, z. Rexhep Bekteshi, është kryer një proces i plotë hetimi administrativ, sipas dispozitave ligjore të kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në deklaratimet e subjektit pranë ILDKPKI-së, provat shkresore të administruara nga ky institucion dhe raporti i dorëzuar pranë Komisionit, çdo dokument ligjor që përbën mjet prove ligjore të kërkuar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit sipas nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, si dhe komunikimet me subjektin sipas nenit 46 të këtij ligji dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative.

Hetimi paraprak administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë, konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklaratimeve të rreme; (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim verifikimin nëse subjekti ka bërë deklaratime të pamjaftueshme për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimit të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

- Nga përbërja familjare sipas certifikatës me nr. ***, lëshuar në datën 04.01.2017, nga Zyra e Gjendjes Civile Durrës 2, rezulton që persona të lidhur në kuptim të pikës 13, të nenit 3, të cilët mbartin detyrimin për deklaratim në zbatim të nenit të nenit 32¹, të ligjit nr. 84/2016, janë bashkëshortja e subjektit, znj. M. B, dhe djali i tij, E. B.

Hetimi administrativ nga ana e Komisionit, sipas neneve 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84 /2016, është kryer në lidhje me pasuritë e subjektit të rivlerësimit, si vijojnë:

1. Apartament banimi, në adresën: Lagjja nr. ***, Rr. “****”, p. ***, shk. ***, ap. ***, me sip. 70.66 m², Durrës, e privatizuar në datën 29.06.1993, nga Ndërmarrja Komunale Banesa Durrës me kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., vlera: 12.959 lekë. Paga nga kursimet e pagës së subjektit dhe të bashkëshortes. Pjesa takuese: 50 %.

1.1 Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se:

(i) ZVRPP-ja Durrës² konfirmon pasurinë ***, të llojit apartament, me sip. 70.66 m², në emër të subjektit dhe bashkëshortes së tij.

(ii) OSHEE-ja³ informon se, z. Rexhep Bekteshi, rezulton abonent⁴ për këtë pasuri.

përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

¹ Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklaratimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

² Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 10.12.2018, nga ZVRPP-ja Durrës në dosjen e Komisionit.

³ Shihni shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 06.12.2018, nga OSHEE-ja në dosjen e Komisionit.

⁴ Referuar shkresës së OSHEE-së me gjeneralitetet Rexhep Bekteshi identifikohen dy abonentë në instancën e Durrësit dhe në instancën e Tiranës, dhe dy abonentë me gjeneralitetet M. B në instancën e Shkodrës. Nga verifikimi i gjeneraliteteve Rexhep Bekteshi në RGJC, abonenti në instancën e Tiranës është i datëlindjes 1939 pra nuk përputhet me subjektin tonë i cili është i

(iii) UKT-ja⁵ nuk konfirmon kontratë të shërbimeve ujësjellës-kanalizime të regjistruara në emër të subjektit dhe të personave të lidhur, por subjekti ka vënë në dispozicion librezën e pagesave të shërbimeve të UKT-së Durrës për kontratën me nr. ***, në emër të z. Rexhep Bekteshit.

Përputhen të dhënat e deklaruara nga subjekti me të dhënat e marra nga institucionet.

1.2 Kjo pasuri është deklaruar në deklaratat periodike si vijon:

(i) Në deklarinimin për vitin 2003 është deklaruar apartament banimi 3+1, lagjja nr. ***, Rr. “***”, p. ***, me nr. e datë regjistrimi në hipotekë nr. ***, datë 17.07.1996, përbërë nga një dhomë, kuzhinë, aneks, banjë dhe ballkon. Burim krijimi: ligji për privatizimin e banesave shtetërore.

(ii) Në deklaratën “Vetting” si në pikën 1 më sipër.

Nuk kanë rezultuar pasaktësi në deklarime.

1.3 Në lidhje me origjinën është vërtetuar se:

(i) Me kontratë për privatizimin e banesës⁶ të datës 29.06.1993, z. Rexhep Bekteshi, si qiramarrës, ka privatizuar nga Ndërmarrja Komunale Banesa Durrës, banesën nr. ***, lagjja nr. ***, Rr. “***”, përbërë nga një dhomë e një kuzhinë, ndërtuar në vitin 1986, me çmim 12.969 lekë, arkëtuar me mandatarkëtimin nr. ***, datë 04.06.1993.

(ii) Me certifikatë për vërtetim pronësie⁷, lëshuar në datën 31.01.2005, nga Zyra e Regjistrimit Durrës, rezulton e regjistruar në emër të Rexhep Bekteshit dhe M. B, pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, zk ***, e llojit apartament me sip. 70,66 m², me adresë: Lagjja nr. ***, Rr. “***”, p. ***, shk. ***, ap. ***, Durrës.

Nuk kanë rezultuar dyshime lidhur me origjinën e kësaj pasurie.

1.4 Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, kursimet e subjektit dhe bashkëshortes nga pagat, nisur nga periudha e fitimit të pronësisë me privatizim (1993), si dhe nga vlera e vogël e çmimit të blerjes (12.969 lekë), kjo pasuri nuk është përfshirë në analizën financiare dhe prezumohet se subjekti ka pasur mundësi financiare për krijimin e saj.

2. Shtesë e apartamentit të mësipërm, me sip. 36,21 m², e ndërtuar nga shoqëria “***” sh.p.k., me NIPT ***, me leje ndërtimi nr. ***, datë 07.08.1995, miratuar nga KKRT-ja Durrës. Ndërtimi ka përfunduar në vitin 1996. Vlera: 450.000 lekë. Pagesa është bërë nga kursimet e pagës së subjektit dhe të bashkëshortes. Pjesa takuese: 100 %.

2.1 Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se:

datëlindjes 1957. Nga verifikimi i gjeneraliteteve në emër të M. B rezulton se abonenti në instancën e Shkodrës është i ditëlindjes 1967 dhe nuk përputhet me bashkëshorten e subjektit e cila është e datëlindjes 28.06.1962.

⁵ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 10.12.2018, nga UKT-ja në dosjen e Komisionit.

⁶ Shihni kontratën për privatizimin e banesës së datës 29.06.1993, në Aneksin 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁷ Shihni certifikatën për vërtetim pronësie lëshuar në datë 31.01.2005, nga Zyra e Regjistrimit Durrës në Aneksin 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

ZQRPP-ja⁸ konfirmon se në emër të z. Rexhep Bekteshi rezulton e regjistruar pasuria me nr. ***, zk ***, e llojit apartament me sip. 36.21 m².

2.2 Kjo pasuri është deklaruar në deklaratat periodike si vijon:

(i) Në deklarinimin për vitin 2003 janë deklaruar (përveç apartamentit ekzistues), dy dhoma shtesë me leje ndërtimi, ndërtuar në vitin 1995, me shpenzimet prej 400.000 lekësh, nga kursimet shumëvjeçare.

(ii) Në deklaratën “Vetting” si në pikën 2 më sipër.

Ka mospërputhje të vlerës së paguar, në deklarinimin e vitit 2003 (400.000 lekë), me deklaratën “Vetting” (450.000 lekë).

Me vërtetimin nr. ***, datë 12.10.2016, lëshuar nga shoqëria e ndërtimit “****” sh.p.k.,⁹ rezultoi se vlera e saktë e punimeve është 450.000 lekë, shumë e cila është marrë në konsideratë në analizën financiare për periudhën 1993 - 2000, brenda së cilës është kryer pagesa. Nga kjo analizë, ka rezultuar se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme për justifikimin e kësaj shume.

2.3 Në lidhje me ndërtimin dhe regjistrimin e shtesës në emër të subjektit, pranë ZVRPP-së, Durrës: duke qenë se ka pasur paqartësi për mënyrën si është regjistruar shtesa me sip. 36 m², në emër të subjektit, i është kërkuar informacion ZVRPP-së Durrës¹⁰, si dhe është kërkuar dosja e vendimit gjyqësor nr. ***, datë 21.06.1996, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës¹¹, me qëllim verifikimin e të gjitha procedurave ligjore të ndjekura për ndërtimin dhe regjistrimin e shtesës në emër të subjektit. Pas verifikimit të materialeve të vëna në dispozicion nga këto institucione, si dhe sqarimeve dhe dokumenteve që subjekti ka vënë në dispozicion¹², u konstatua se:

(i) Me leje ndërtimi¹³ nr. ***, datë 07.08.1995, të KRRT-së Durrës, u lejua firma “****” sh.p.k., të ndërtojë shtesë anësore në pallatin nr. ***, Durrës, me investitorë shtetasit B. K., A. V., R. Bekteshi, R. B. e P. N. (banorët e shtesës së pallatit).

(ii) Me vendimin nr. ***, datë 21.06.1996, Gjykata e Rrethit Durrës¹⁴, ka vendosur vërtetimin e faktit të njohjes pronar të shtetasit Rexhep Bekteshi të shtesës së apartamentit me sip. 47 m².

Pasi është administruar dosja e vendimit nr. ***, datë 21.06.1996, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës,¹⁵ rezultoi se me kërkesëpadinë e datës 30.05.1996, paditësi Rexhep Bekteshi, me palë të paditur Komuna e lagjes nr. ***, Durrës, ka kërkuar vërtetimin e faktit të pronësisë

⁸ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 2.11.2017, nga ZQRPP-ja, drejtuar ILDKPKI-së në Aneksin 28 të dosjes së ILDKPKI-së.

⁹ Shihni vërtetimin nr. ***, datë 12.10.2016, lëshuar nga shoqëria e ndërtimit “****” sh.p.k., në Aneksin 4/3 në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁰ Shihni shkresën kthim përgjigje nr. ***prot., datë 25.02.2019, nga ZVRPP-ja Durrës, në dosjen e Komisionit.

¹¹ Shihni shkresën kthim përgjigje nga Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor nr. ***prot., datë 25.02.2019, në dosjen e Komisionit.

¹² Shihni përgjigjet e pyetësorit shtesë të pyetësorit nr. ***, dërguar nga subjekti në datë 26.02.2019, në dosjen e Komisionit.

¹³ Shihni dokumentin leje ndërtimi nr. ***, datë 07.08.1995, bashkëngjitur shkresës kthim përgjigje nr. ***prot., datë 02.11.2017, në Aneksin 28 të dosjes së ILDKPKI-së.

¹⁴ Shihni vendim nr. ***, datë 21.06.1996, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në Aneksin 4/3 në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁵ Shihni shkresën kthim përgjigje nga Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor, nr. ***prot., datë 25.02.2019, në dosjen e Komisionit.

mbi shtesën me sip. ndërtimore 47 m². Nga përmbajtja e dosjes së mësipërme, vërehet se kërkesa e shtetasit Rexhep Bekteshi për vërtetimin e faktit është paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, në territorin e së cilës ka banimin kërkuesi dhe aty ku ndodhet sendi, në përputhje me nenin 388 të Kodin e Procedurës Civile, në përfundim është vendosur pranimi i kërkesës dhe vërtetimi i faktit të pronësisë, pa pasur një akt kolaudimi për shtesën, por vetëm mbi deklaratimet e administratorit të shoqërisë, lejes së ndërtimit, kontratën e privatizimit të apartamentit dhe skicën përkatëse. Çështja është gjykuar nga gjyqtarja F. H dhe në seancë gjyqësore janë thirrur edhe dy dëshmitarë, njëri ndër të cilët administrator i shoqërisë “****” sh.p.k., i cili ka ndërtuar shtesën.

(iii) Kjo pasuri është regjistruar në hipotekën Durrës në datën 17.07.1996, pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, të datës 21.06.1996, me anë të të cilit z. Rexhep Bekteshi u njoh pronar i shtesës së apartamentit të banimit, të përbërë nga dy dhoma, një banjë dhe ballkon me sip. ndërtimore prej 47 m².

(iv) Akti i kolaudimit, datë 18.12.2004, për 5 katet shtesë të pallatit, konfirmon se punimet për këtë shtesë kanë nisur në vitin 1995 dhe kanë përfunduar më 1997-n, dhe se sipërfaqja e ndërtimit të shtesës së banesës për çdo kat është 36,21 m²; me gjithë ballkonin është 40,63 m².

(v) Me certifikatë për vërtetim pronësie¹⁶, lëshuar në datën 15.07.2005, në emër të z. Rexhep Bekteshi është regjistruar pasuria nr. ***, apartament me sip. 36,21 m² në adresën: Lagjja nr. ***, Rr. “****”, k. ***, ap. ***, shk. ***.

(vi) Me vërtetim nr. ***¹⁷, datë 12.10.2016, lëshuar nga shoqëria e ndërtimit “****” sh.p.k., vërtetohet se kjo shoqëri ka ndërtuar në vitin 1996 shtesën e apartamentit të banimit nr. ***, me adresë: Lagjja nr. ***, Rr. “****”, në pronësi të shtetasit Rexhep Bekteshi, me sip. 36,2 m², në vlerën prej 450.000 lekësh.

(vii) Nga verifikimi në faqen zyrtare të QKB-së¹⁸ mbi aktivitetin e ushtruar nga shoqëria “****” sh.p.k., rezultoi se ajo është themeluar në datën 12.09.1994, dhe është regjistruar në gjykatë në datën 22.09.1994, me administrator K. K., me aktivitet në fushën e ndërtimeve, të rikonstruksioneve, etj.

(viii) Është pyetur subjekti në lidhje me mospërputhjen e sipërfaqes së shtesës sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe sipërfaqes së regjistruar në ZVRPP, i cili ka sqaruar¹⁹ se, në vendimin e gjykatës sipërfaqja prej 47 m² është shkruar gabimisht dhe se sipërfaqja reale e shtesës është 36,2 m², aq sa është në certifikatën e pronësisë të lëshuar nga ZVRPP-ja Durrës.

Nga të gjitha të dhënat si më sipër rezulton se, shtesa anësore me sip. 36,21 m², p. ***, shk. ***, ap. ***, është ndërtuar ligjërisht me leje ndërtimi lëshuar nga organet kompetente ligjore dhe se subjekti i rivlerësimit e ka regjistruar fillimisht këtë shtesë me vendim gjykate për vërtetim fakti, në vitin 1996, pra, përpara se të përpilohej akti i kolaudimit të saj, pikërisht për

¹⁶ Shihni certifikatën për vërtetim pronësie lëshuar në datë 15.07.2005, nga Zyra e Regjistrimit Durrës, në Aneksin 4/3 në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁷ Shihni vërtetimin nr. ***, datë 12.10.2016, lëshuar nga shoqëria e ndërtimit “****” shpk., në Aneksin 4/3 në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁸ Shihni ekstraktin historik të printuar nga faqja zyrtare e QKB-së në dosjen e Komisionit.

¹⁹ Shihni përgjigjet e pyetësorit shtesë të pyetësorit nr. 2, dërguar nga subjekti në datën 26.02.2019, në dosjen e Komisionit.

shkak se ende nuk kishte një akt kolaudimi. Ky akt (përpiluar në datën 18.12.2004), i paraqitur më pas në ZVRPP-në Durrës, me qëllim regjistrimin shtesës për të gjithë banorët e pallatit, nuk përmban të dhëna që të vijnë në kundërshtim me vendimin e gjykatës, mbi bazën e të cilit subjekti ka regjistruar fillimisht shtesën e emër të tij. Ndërkohë, as nga dosja gjyqësore për çështjen me objekt vërtetimin e faktit të pronësisë, dhe as nga ndonjë burim tjetër, nuk ka të dhëna e informacione që subjekti i rivlerësimit të ketë përfituar shtesën e apartamentit për shkak të statusit të tij si gjyqtar.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni, krijoi bindjen se shtesa me sip. 36,21 m², është përfituar në mënyrë të ligjshme nga subjekti i rivlerësimit.

3. Llogari rrjedhëse në “Alpha Bank”, nr. ***, nga paga personale si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, deri më datën 20.01.2017, në vlerën prej 675.171 lekësh. Pjesa takuese: 100 %.

4. Depozitë bankare me afat njëvjeçar pranë “Alpha Bank”, e krijuar më datë 05.11.2015, nga kursimet e llogarisë rrjedhëse nr. ***, të pagës personale si gjyqtar, në vlerë prej 505.540 lekësh. Pjesa takuese: 100%.

Gjatë hetimit administrativ, u verifikuan të dyja llogaritë dhe u konstatua se deklaratimet e subjektit përputhen me të dhënat e vëna në dispozicion nga “Alpha Bank”²⁰.

- Gjatë hetimit administrativ, nuk u konstatuan pasuri të tjera në përdorim apo pronësi të subjektit, nga ato të deklaruara në deklaratën “Vetting”.

PASURI TË PERSONAVE TË LIDHUR:

Bashkëshortja e subjektit, znj. M. B., ka deklaruar:

1. Apartament banimi nr. ***, në adresën: Lagjja nr. ***, Rr. “****”, p. ***, shk. ***, me sip. prej 70,66 m², e privatizuar në datën 29.06.1993, nga Ndërmarrja Komunale Banesa Durrës, më kontratë nr. *** rep., nr. *** kol. Vlera: 12.959 lekë. Pjesa nga kursimet e pagës. Pjesa takuese: 50 %.

E trajtuar më sipër.

2. Llogari rrjedhëse nr. ***, në “Raiffeisen Bank”, nga paga personale si drejtoreshë e shkollës 9-vjeçare “****”, Durrës, deri në datën 09.01.2017, në vlerën 49.901 lekë.

3. Kartë krediti “Master Card”, në vlerën 0 lekë, e cila faturohej në llogarinë rrjedhëse nr. ***, në “Raiffeisen Bank”. Karta është hapur në datën 31.10.2013, dhe është mbyllur në datën 16.02.2015.

4. Llogari bankare në “Raiffeisen Bank” me nr. *** në euro, në vlerën 0 euro, hapur në datën 21.10.2014, dhe mbyllur në datën 09.11.2015, për llogari të shkollës 9-vjeçare “****”, Durrës,

²⁰ Shihni shkresën nr. ***, datë 19.12.2018, të “Alpha Bank”, në dosjen e Komisionit.

në kuadër të projektit të SWCEL (Zagreb, Kroaci), “Edukimi për sipërmarrje”, ku merr pjesë institucioni që drejton bashkëshortja e subjektit, për llogari të shkollës “****”.

5. Llogari e hapur në funksion të shkollës “****”, në vlerën 0 lekë, nga Bordi i Prindërve dhe të përdorura për nevojat e shkollës me nr. ***, në datën 22.08.2008 dhe mbyllur në datën 11.09.2014, për shkak se institucioni nuk ka pasur NIPT.

“Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 03.12.2018, ka konfirmuar deklaratimet e subjektit të rivlerësimit²¹ lidhur me këto llogari.

Djali i subjektit, E. R, ka deklaruar:

1. Automjet, tip “Volkswagen”, Golf 3, i vitit 1997, regjistruar me targë ***, pranë DPSHTRR-së Durrës. Mjeti i blerë me kontratë shitblerjeje nr. *** rep., dhe nr. *** kol., në datën 07.04.2009, në vlerën 300.000 lekë. Mjeti është blerë me kursimet nga pagat e prindërve. Pjesa takuese: 100 %.

Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se DPSHTRR-ja²² ka konfirmuar se në emër të z. E. Rexhep Bekteshi ka qenë i regjistruar automjeti me targë ***, tip “Volkswagen”, i shitur në datën 07.06.2017, pra, pas deklaratës “Vetting”.

Kjo pasuri është deklaruar në deklaratat periodike si vijon:

(i) Në deklarinimin për vitin 2009, është deklaruar nga subjekti dhe djali i tij, një autoveturë tip “Volkswagen”, Golf 3, i blerë nga djali, E. B, për shumën prej 300.000 lekësh.

(ii) Në deklaratën “Vetting” si në pikën 1 më sipër.

Nuk ka pasaktësi në deklarime dhe as dyshime lidhur me këtë pasuri.

Nga analiza financiare për vitin 2009, rezultoi se subjekti ka pasur burime të ligjshme për të kontribuar në blerjen e automjetit në pronësi të djalit të tij, në vitin 2009.

2. Llogari rrjedhëse nga paga personale si inspektor pranë Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor Durrës, pranë “Credins Bank”, me nr. ***. Deri në datën 31.12.2016 vlera ka qenë në shumën prej 397.084 lekësh. “Credins Bank”, me shkresën nr. ***, datë 14.01.2019, e konfirmon këtë llogari.

3. Marrje automjeti me qira në “****”, në aeroportin e Fiumiçionos, Romë, në datën 09.11.2016. Shuma është paguar me kartë debiti nga llogaria rrjedhëse nr. *** në “Credins Bank”. “Credins Bank”, me shkresën nr. ***, datë 14.01.2019, konfirmon transaksion nga llogaria e E. B me nr. ***, në datën 14.11.2016, në shumën prej 14.267,92 lekësh, ndaj “****”.

Subjekti është pyetur për shpenzimet e djalit gjatë periudhës së shkollimit në Tiranë²³ dhe ka deklaruar se gjatë periudhës së studimeve, djali ka jetuar në të njëjtin apartament në të cilin banojnë familjarisht. Udhëtimet ditore drejt Fakultetit të Mjekësisë, Universiteti i Tiranës, i ka

²¹ Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2, dërguar nga subjekti Rexhep Bekteshi në datë 08.02.2019, në dosjen e Komisionit.

²² Shihni shkresë kthim përgjigje nr. ***prot., datë 03.08.2017 nga DPSHTRR-ja në Aneksin 30, në dosjen e ILDKPKI-së.

²³ Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2, dërguar nga subjekti Rexhep Bekteshi në datë 08.02.2019, në dosjen e Komisionit.

kryer me mjetet e transportit publik (autobusët interurbanë Durrës - Tiranë dhe autobusët urbanë të transportit qytetas).

Vajza e subjektit, B. B:

Nga përbërja e certifikatës familjare të dorëzuar nga subjekti të lëshuar në datën 04.01.2017, nga Zyra e Gjendjes Civile 2, Durrës, rezulton se znj. B. B nuk ka qenë pjesë e saj, megjithatë, ajo e ka plotësuar deklaratën e personit të lidhur, e cila është verifikuar gjatë hetimit administrativ, për pasuritë e deklaruara, si vijon:

1. Llogari rrjedhëse në “Credins Bank” Durrës, me nr. llogarie ***, nga paga si punonjëse pranë ALUIZNI-t Durrës, për periudhën 12.03.2014 – 31.12.2014, në vlerën prej 27.796 lekësh, e konfirmuar nga “Credins Bank” me shkresën nr. ***, datë 14.01.2019.

2. Llogari depozite në “Raiffeisen Bank” Durrës, me nr. llogarie *** (në euro) e krijuar nga kursimet e pagës mujore. Llogaria është mbyllur në datën 30.12.2016, në vlerën prej 0 eurosh, e konfirmuar nga “Raiffeisen Bank” me shkresën nr. *** prot., datë 03.12.2018.

3. Llogari rrjedhëse në “Societe Genereale Bank” me nr. llogarie ***, nga paga si punonjëse në “****” sh.p.k., Durrës, me NIPT ***, prej datës 15.01.2016 e deri në datën 30.12.2016, në vlerën prej 260.836,50 lekësh, e konfirmuar nga “Societe Generale Bank”, me shkresën nr. ***, datë 09.01.2019.

Në përgjigjet e pyetësorit të parë standard, subjekti ka deklaruar se vajza e tij ka studiuar në Greqi në periudhën 2005 - 2012, në universitetin “****” të Selanikut, me bursë në vlerën prej 550 eurosh në muaj dhe ka paraqitur vërtetimin nr. *** prot., datë 15.03.2006, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, me të cilën vërtetohet se znj. B. B ka filluar studimet universitare me bursë në Greqi, në vitin akademik 2005 - 2006.

Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të vërtetuar me dokumente shkresore periudhën e shkollimit në Greqi të vajzës, znj. B. B, si dhe faktin e përfitimit të bursës nga ky shtet për gjithë periudhën e shkollimit.

Në parashtrimet e datës 10.04.2019, subjekti ka vënë në dispozicion shtatë dokumente zyrtare në gjuhën greke, të lëshuara nga Ministria e Arsimit dhe Feve të Republikës së Greqisë, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, nga të cilat vërtetohet se znj. B. B i është akorduar bursë e plotë, si dhe një subvencion mujor prej 500 eurosh për periudhën e studimeve 2005 – 2012. Këto dokumente u paraqitën në versionin origjinal, gjatë seancës dëgjimore.

IV. VLERËSIMI PROFESIONAL

Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit, z. Rexhep Bekteshi, bazuar në:

1. Raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, dërguar me shkresën, nr. *** prot., datë 14.02.2019, i cili ka vlerësuar pozitivisht subjektin e rivlerësimit për aftësitë profesionale, aftësitë organizative,

etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale si dhe aftësitë personale dhe angazhimin profesional.

2. Informacionin e marrë nga burime të ligjshme, ku si të tilla janë konsideruar gjashtë denoncime nga publiku të administruara nga Komisioni, të cilat pasi janë verifikuar, ka rezultuar se vetëm dy prej tyre përmbushin kriteret e parashikuara në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016; (i) denoncimi i shtetases D. Gj²⁴; (ii) denoncimi i avokatit F. Gj²⁵. Veç këtyre denoncimeve, është marrë informacion nga KLGJ-ja, në lidhje me ankesën e paraqitur nga shtetasit M. B, E. N dhe A. Ç.²⁶

Gjatë hetimeve paraprake, pasi u morën në shqyrtim, aktet e dosjeve përkatëse në lidhje me; (i) denoncimin e znj. D. Gj²⁷; (ii) denoncimin e z. F. Gj²⁸; si dhe (iii) aktet në lidhje me ankimin e paraqitur pranë KLGJ-së²⁹, në përfundim të hetimeve paraprake, subjektit iu kërkuan sqarime:

2.1 Në lidhje me pretendimet e avokat F. Gj, se,

(i) është tejkualuar afati 30 ditor i dërgimit të çështjes në gjyq sipas pikës 2, të nenit 332, të Kodit të Procedurës Penale, pasi nga regjistrimi i çështjes, datë 31.07.2018, deri në marrjen e vendimit datë 14.09.2018, kanë kaluar afërsisht 1.5 muaj;

(ii) nuk është njoftuar mbrojtësi i të pandehurit për datën e seancës dhe të drejtën për t'u njohur me aktet, të paktën 10 ditë para seancës, sipas pikave 2 dhe 3, të nenit 332/1, të Kodit të Procedurës Penale.

2.2 Në lidhje me pretendimin e shtetases D. Gj, se,

(i) ka zvarritje në gjykim, në tejkalim të afatit 9-mujor të parashikuar në germën a, pika 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.

2.3 Në lidhje me ankesën e paraqitur nga shtetasit M. B, E. N dhe A. Ç, pranë KLGJ-së,

(i) sipas së cilës, nga ana e gjyqtarit Rexhep Bekteshi, është tejkualuar afati 10 ditor i gjykimit, i parashikuar në nenin 325 të Kodit të Procedurës Penale.

Pasi u njoh me rezultatet e hetimit paraprak, në parashtrimet e datës 10.04.2019, por edhe në seancën dëgjimore, subjekti paraqiti pretendimet e tij, si dhe dokumente shpresore të cilat, pasi u morën, u shqyrtuan në përfundim të procesit të rivlerësimit. Në përfundim, Komisioni, çmoi se:

Në lidhje me denoncimin e shtetases D. Gj:

²⁴ Shihni ankimin e shtetases D. Gj, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 26.09.2018, në dosjen e Komisionit.

²⁵ Shihni dokumentin nr. *** prot., datë 25.12.2018, drejtuar Komisionit nga Av. F. Gj nga Dhoma e Avokatëve Durrës, për gjyqtarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Rexhep Bekteshi, kandidat për anëtar të Gjykatës Kushtetuese.

²⁶ Shihni relatimin e inspektorese ZH.P. mbi verifikimin e ankesës së shtetasve M. B, E. N dhe A. Ç, ndaj gjyqtarit Rexhep Bekteshi bashkëngjitur shkresës kthim përgjigje nga KLGJ-ja nr. *** prot., datë 01.03.2019, në dosjen e Komisionit.

²⁷ Shihni shkresë nr. *** prot., datë 13.03.2019, dhe dokumentet shoqëruese, dërguar nga Gjykata e Apelit Durrës në dosjen e Komisionit.

²⁸ Shihni shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 05.03.2019, dhe fashikujt nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, në dosjen e Komisionit

²⁹ Shihni shkresën kthim përgjigje nga KLGJ-ja, nr. ***prot., datë 01.03.2019, në dosjen e Komisionit

- Subjekti ka dhënë sqarime³⁰ të hollësishme mbi shkaqet e kohëzgjatjes së këtij gjykimi si vijon: (i) nga ana e prokurorisë ishte kryer një akt ekspertimi i parregullt pasi ishte caktuar një ekspert autoteknik i cili nuk kishte njohuri të posaçme në fushën e aksidenteve dhe shkëljes së rregullave të mbrojtjes në punë; (ii) trupi gjykues, i ndodhur përpara këtij fakti, në kuadër të një shqyrtimi gjyqësor objektiv dhe të gjithanshëm, vlerësoi të domosdoshme kryerjen e një ekspertimi teknik me grup ekspertësh inxhinierë me dije të veçanta të fushës përkatëse; (iii) gjatë gjykimit lindi nevoja që ekspertët të bënin një shtesë akti ekspertimi për të sqaruar rrethanat e aksidentit të ndodhur në punë, ku djali i ankuses, shtetasi A. Gj, ishte plagosur rëndë; (iv) gjatë gjykimit, palët në proces kërkuan që ekspertët që kishin përpiluar aktin e ekspertimit teknik dhe shtesën e tij të jepnin shpjegime në seancë gjyqësore.

- Subjekti ka vënë në dispozicion vendimin nr. ***, datë 23.01.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në të cilin sipas tij pasqyrohen veprimet procedurale të mësipërme.

Nisur nga sqarimet e subjektit mbi shkaqet e kohëzgjatjes së gjykimit të kësaj çështjeje, dhe ballafaqimi i tyre me procesverbalet e seancave gjyqësore, vërtetohen pretendimet e tij se kjo kohëzgjatje ka ardhur jo për shkak të veprimeve ose mosveprimeve nga ana e tij, por për shkaqe objektive.

Në lidhje me denoncimin e avokatit F. Gj:

- Pretendimi i tij, se subjekti ushtron detyrën e gjyqtarit, në kundërshtim me ligjin nr. 10034, datë 22.12.2008, “Për pastërtinë e figurës së funksionarëve të lartë të administratës publike dhe të zgjedhur”, rezultoi i pabazuar, pasi ligji të cilit denoncuesi i referohet, është shfuqizuar si i papajtueshëm me Kushtetutën nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 9, datë 23.03.2010.

Për sa i takon pretendimit, se nuk është njoftuar mbrojtësi i të pandehurit për datën e seancës dhe të drejtën për t’u njohur me aktet, të paktën 10 ditë para seancës, sipas pikave 2 dhe 3 të nenit 332/1, të Kodit të Procedurës Penale, në parashtrimet e tij³¹, subjekti ka deklaruar se volumi i akteve prej 13 fashikujsh i është vënë në dispozicion të gjithë avokatëve mbrojtës të 9 personave, përfshirë dhe avokatin denoncues, provuar kjo me procesverbalin gjyqësor të datës 13.09.2018, ku avokati F. Gj ka paraqitur kërkesë me shkrim dhe ka kërkuar gjykimin e çështjes me procedurë të shkurtuar, duke theksuar se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet në dosjen gjyqësore. Këto fakte, vërtetojnë se, avokati F. Gj ishte njohur me aktet e dosjes, i kishte studiuar ato dhe, për këtë arsye kishte vlerësuar se çështja mund të zgjidhej në gjendjen që ishin aktet.

Për sa i takon pretendimit, se është tejkaluar afati 30 ditor i dërgimit të çështjes në gjyq sipas pikës 2 të nenit 332 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti në parashtrimet e tij³², ka sqaruar se çështja e referuar, është regjistruar në gjykatë më 31 korrik 2018, dhe ditën tjetër, pra të nesërmen, ka nisur lejen e zakonshme vjetore njëmuajore, e cila ka zgjatur deri, më 03.09.2018,

³⁰ Shihni parashtrimet dhe dokumentet shoqëruese, dërguar nga subjekti në rrugë elektronike, më datë 10.04.2019, në dosjen e Komisionit.

³¹ Shihni parashtrimet dhe dokumentet shoqëruese, dërguar nga subjekti në rrugë elektronike, më datë 10.04.2019, në dosjen e Komisionit.

³² Shihni parashtrimet dhe dokumentet shoqëruese, dërguar nga subjekti në rrugë elektronike, më datë 10.04.2019, në dosjen e Komisionit.

periudhë gjatë së cilës gjykatat shqyrtojnë vetëm masat e sigurimit. Më datë 14.09.2018 ka përfunduar shqyrtimi i çështjes dhe është dhënë vendimi.

Nisur nga sqarimet e subjektit, duke mbajtur në konsideratë periudhën e lejes vjetore për të gjithë gjyqtarët, vërtetohet se kohëzgjatja e gjykimit të çështjes, ka ardhur për shkak të periudhës së lejes vjetore, dhe jo për shkaqe të varura nga subjekti i rivlerësimit.

Në lidhje me konstatimet për tejkalim të afateve të gjykimit të çështjes të pretenduar nga ankuesit M. B, E. N dhe A. Ç.

Në parashtrimet e tij³³ subjekti pranoi se, gjykimi ka zgjatur për një periudhë 2-mujore, pra, në tejkalim të afatit 10 ditore të gjykimit të parashikuar në nenin 325 të Kodit të Procedurës Penale, me sqarimin se avokati mbrojtës i ankuesve nuk është paraqitur në tre seanca, por vetëm në seancën e datës 18.01.2016, kur është dhënë vendimi, dhe ka paraqitur: (i) vendimin nr. (***)**,***, datë 18.01.2016, datë regjistrimi 18.11.2015; (ii) procesverbale të seancave gjyqësore, datë 07.12.2015, 21.12.2015, 08.01.2016 dhe 18.01.2016, me të cilat vërtetohet se shtyrja e seancave gjyqësore ka ardhur për shkak të mosparaqitjes në gjykim të ankuesve dhe avokatit mbrojtës të tyre, dhe jo për shkaqe që varen nga subjekti.

3. Vlerësimi i aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit sipas kriterëve të parashikuara në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, sipas kriterëve të parashikuara në kreun II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, rezultoi se:

- subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi profesionale, sipas nenit 72 të ligjit nr. 96/2016;
- subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi organizative, sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016;
- subjekti i rivlerësimit ka një nivel të lartë të etikës dhe angazhim ndaj vlerave profesionale, sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016;
- subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional, sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016.

Në përfundim, sipas nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, z. Rexhep Bekteshi, është vlerësuar “i aftë” profesionalisht.

V. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues, ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016.

Subjekti ka qenë i gatshëm, duke u treguar tërësisht bashkëpunues, pasi i është përgjigjur me korrektesë brenda afateve të caktuara të gjitha pyetjeve, duke dhënë në mënyrë shteruese

³³ Shihni parashtrimet dhe dokumentet shoqëruese, dërguar nga subjekti në rrugë elektronike, më datë 10.04.2019, në dosjen e Komisionit.

informacionin e kërkuar, gjë e cila është mbajtur në konsideratë në marrjen e vendimit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016.

VI. SEANCA DËGJIMORE

Më datë 26.04.2019 u zhvillua seanca dëgjimore sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Rexhep Bekteshi, gjatë së cilës ai kërkoi konfirmimin në detyrë.

Trupi gjykues i Komisionit, nisur nga rezultatet e hetimit administrativ lidhur me pasurinë, figurën dhe aftësitë profesionale, vlerësoi se procesi i vendimmarrjes në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Rexhep Bekteshi, duhet të bazohet në vlerësimin tërësor të tri kritereve, referuar pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim të seancës dëgjimore, trupi gjykues i Komisionit, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, komisioneren Firdes Shuli, e cila rekomandoi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, dëgjoji subjektin, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë, dhe pasi administroi dokumentet shkresore, përfundoi procedurën e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Rexhep Bekteshi, dhe shpall këtë vendim sot, më datë 26.04.2019, sipas pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

VII. KONKLuzion PËRFUNDIMTAR

1. Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, kreut IV të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Rexhep Bekteshi, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë sipas germës a, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016;

2. Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Rexhep Bekteshi, ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës sipas germës b, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016;

3. Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës, kreut VI të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas germës c, të neni 59/1, të e ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës a, pika 1, të nenit 58, dhe bazuar në pikën 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Rexhep Bekteshi, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 26.04.2019.

ANTËTARËT E TRUPIT GJYKUES

KRYESUES
Roland ILIA

RELATORE
Firdes SHULI

ANËTARE
Brunilda BEKTESHI

Sekretare gjyqësore
Anisa Duka